

20151925290

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI TURISTIKE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 89/2008, 12/2009, 17/11, 47/11, 53/11, 123/12, 164/13, 27/14 dhe 116/15), në nenin 65 në paragrafët 2 dhe 3 fjalët: "Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë" zëvendësohen me fjalët: "Komisioni Shtetëror për Vendosje në Shkallë të dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës së Kundërvajtjes".

Neni 2

Në nenin 66-a paragrafin 1 presja para numrit "67" dhe numri "67" shlyhen.
Paragrafi 3 ndryshohet si vijon:
"Për kundërvajtjen nga neni 71 procedurë të kundërvajtjes dhe sanksion të kundërvajtjes shqipton gjykata kompetente."

Neni 3

Në nenin 67 paragrafin 1 fjalia hyrëse ndryshohet si vijon:
"Gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, nëse".

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, personit fizik, inspektori i autorizuar i komunës dhe inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit, do të zbatojnë procedurë për barazim me dhënie të urdhërpagesë mandatore, për pagesë të gjobës në shumën e caktuar, në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të urdhërpagesës mandatore".

Paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

"Nëse personi fizik nuk e paguan vullnetarisht gjobën në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, urdhërpagesa mandatore ka fuqi të dokumentit ekzekutiv dhe inspektori i autorizuar i komunës dhe inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit, do ta dorëzojë te organi kompetent për përmbarrim të detyrueshëm, për përmbarrim të saj".

Pas paragrafit 3 shtohen katër paragrafë të rinj 4, 5, 6 dhe 7 si vijojnë:

"Inspektori i autorizuar i komunës dhe inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit janë të obliguar të mbajnë evidencë për urdhërpagesat mandatore të lëshuara dhe për rezultatit e procedurave të ngritura.

Në evidencën nga paragrafi 4 i këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht titulli i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës mandatore e cila i jepet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 5 i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e vendosjes në evidencë.

Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës mandatore i përcakton ministri i Ekonomisë".

Neni 4

Në nenin 68 paragrafin 1 në fjalinë hyrëse, fjalët: "në vendin e ngjarjes" shlyhen, ndërsa pas fjalëve: "personi juridik" shtohen fjalët: "përkatësisht tregtar individ",

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur e personit juridik, përkatësisht të tregtarit individ do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik, përkatësisht personit përgjegjës te tregtari individ, për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni".

Paragrafët 3, 4 dhe 5 shlyhen:

Neni 5

Neni 68-a shlyhet.

Neni 6

Në nenin 70 në paragrafin 1 në fjalinë hyrëse pas fjalëve: "personi juridik" shtohen fjalët "përkatësisht tregtari individ".

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shume prej 30% nga gjoba e matur e personit juridik, përkatësisht tregtarit individ do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik, përkatësisht personi përgjegjës te tregtari individ, për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni".

Paragrafët 3 dhe 4 shlyhen.

Neni 7

Në nenin 71 në paragrafin 1 në fjalinë hyrëse fjalët: "2.000 deri në" shlyhen, ndërsa pas fjalëve: "personi juridik" shtohen fjalët: "përkatësisht tregtari individ".

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shume prej 30% nga gjoba e matur e personit juridik, përkatësisht e tregtarit individ do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik, përkatësisht personi përgjegjës te tregtari individ, për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni."

Paragrafi 3 ndryshohet si vijon

"Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur e personit juridik, përkatësisht e tregtarit individ do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës te agjencia e huaj turistike, për grup të organizuar të turistëve, për veprimet nga paragrafi 1 pika 8 të këtij neni".

Paragrafët 4 dhe 5 shlyhen.

Neni 8

Pas nenit 71 shtohen dy nene të reja 71-a dhe 71-b si vijojnë:

"Neni 71-a

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 68, 70 dhe 71 të këtij ligji, personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, inspektori shtetëror i tregut, para parashtrimit të kërkesës për ngritje të procedurës së kundërvajtjes do të zbatojë procedurë për barazim me dhënie të urdhërpagesës së kundërvajtjes.

Kur inspektori shtetëror i tregut do të konstatojë kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni përpilon procesverbal në të cilin shënohen elementet e rëndësishme të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e hasur në vendin e ngjarjes. Procesverbalin e nënshkruan personi i autorizuar zyrtar dhe kryerësi. Nëse kryerësi e pranon kundërvajtjen inspektori shtetëror i tregut do t'i japë urdhërpagesë të kundërvajtjes për pagesë të gjobës për kundërvajtje.

Pas pranimit dhe nënshkrimit të urdhërpagesës së kundërvajtjes, kryerësi i kundërvajtjes është i obliguar ta paguajë gjobën në afat prej tetë ditësh nga pranimi i urdhërpagesës së kundërvajtjes, në llogari të shënuar në urdhërpagesë.

Kryerësi i kundërvajtjes i cili do ta paguajë gjobën në afatin nga paragrafi 3 i këtij neni, do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, për të cilën të drejtë mësohet në mësimin juridik.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi 3 i këtij neni, për kundërvajtjet nga neni 71 të këtij ligji, inspektori shtetëror i tregut parashtron kërkesë për ngritje të procedurës të kundërvajtjes në gjykatën kompetente.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi 3 i këtij neni për kundërvajtjet nga nenet 68 dhe 70 të këtij ligji, inspektori shtetëror i tregut parashtron kërkesë për ngritje të procedurës së kundërvajtjes te organi kundërvajtës, në pajtim me nenin 66-a të këtij ligji.

Inspektorët shtetërorë të tregut, janë të obliguar të mbajnë evidencë për urdhërpagesat të dhëna të kundërvajtjes dhe për rezultatit e procedurave të ngritura.

Në evidencën nga paragrafi 7 i këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës së kundërvajtjes e cila i jepet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 8 i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e vendosjes në evidencë.

Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës së kundërvajtjes e përcakton ministri i Ekonomisë.

Nenin 71-b

Matja e lartësisë së gjobave të personit juridik përkatësisht të tregtarit individ bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje."

Neni 9

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 10

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari turistike.

Nenin 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".